



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 323/3 prot.

Datë 14.02.2024

V E N D I M
Nr. 175/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 120/2024, datë 31.01.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.

Ankimues: “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NUIS M11815028I, me adresë: “Rruga e Kavajes”, Buka SH.A, Nr.8240, Njesia Nr.6, Tirane.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A me adresë: Rruga “Skënderbeu”, Qafë-Gjashtë, Sarandë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 31.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 120/2024, ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, duke e kualifikuar atë.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.127/1 prot., datë 08.02.2024, protokolluar me tonën nr. 323 prot., datë 12.02.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin Nr.120/2024, datë 31.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.127/1 prot., datë 08.02.2024, protokolluar me tonën nr. 323 prot., datë 12.02.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin Nr.120/2024, datë 31.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë*”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë SH.A.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ky verifikim rezultoi, se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 120/2024, datë 31.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, duke kualifikuar operatorin ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë*”, me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë SH.A
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

